



Npi – 01/69 datë: 07.04.2022

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe në bazë të neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës. Si dhe pas procesit të diskutimit Publik, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 07.04.2022, Miratoi:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2022

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2022, e mbajtur më: 07.04.2022, unanimisht miratoi Rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2022, me këto ndryshime:

1. Te Neni 7.2.5 Taksa prej 25 € sa ishte për, (Vetshërbimet SH.P.K) ulet në 15 euro.
2. Te Neni 7.2.13 Taksa prej 25 € sa ishte për (Gurethyesit, Betonjerkat, eksploatuesit e zhavorit) rritet në 35 euro.
3. Te Neni 8.2.4 Për lirim nga taksa Komunale shtohet edhe kategoria (Ish të burgosurit politik).

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi